



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.02.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e hapjes së procedurës për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës” të përgatitur nga Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:14 dhe mbaroi në orën 16:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësuese e OSBE-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e hapjes së procedurës për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës” të përgatitur nga Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Përsëndetje!

Po fillojmë mbledhjen për datën 19.02, viti 2019.

Janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit.

Në rendin e ditës, sikurse jeni vënë në dijeni, janë dy çështje.

E para është shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e hapjes së procedurës për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës”. Dhe çështja e dytë është: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Lidhur me çështjen e parë për shpalljen dhe hapjen e procedurës për komandimin e një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, ia jap fjalën për ta relatuar projekt-aktin, zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Atëherë, siç edhe jeni njohur me relacionin dhe me projekt-aktet bashkëlidhur, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 6, datë 29.01.2019 ka miratuar një vend vakant në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar. Në zbatim të ligjit, Shkolla e Magjistraturës i ka dërguar kërkesë Këshillit të Lartë Gjyqësor për të filluar procedurat për komandimin e një gjyqtari në pozicionin vakant. Nga marrja e kërkesës, në zbatim të ligjit, brenda një afati 15-ditor, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të shprehet lidhur me afishimin e këtij njoftimi për vendin vakant dhe nga ana tjetër duhet të miratojë edhe me anë të një vendimi kriteret dhe rregullat mbi të cilat do të bazohet e gjithë procedura e komandimit të gjyqtarit, bashkë me afatin e dorëzimit të dokumentacionit dhe gjithë procedurën që do të vijojë më tej, deri në momentin e përzgjedhjes dhe komandimit të gjyqtarit.

Ky projekt-akt përmban pikërisht atë çka relatova: shpalljen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve për t'u komanduar me pëlqim në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës; përmban kriteret që duhet të plotësojë gjyqtari; përmban afatin e paraqitjes së kërkesës për komandim, bashkë me dokumentacionin që duhet të depozitohet; më pas janë të parashikuara edhe hapat procedural që do të ndiqen nga Këshilli, konkretisht nga Komisioni i Karrierës në përpunimin e informacionit dhe në shprehjen e mendimit, lidhur me çdo kandidat që aplikon për komandim në pozicionin vakant.

Ajo që shtrohet për diskutim është fakti i kriterëve që duhet të plotësojë, prandaj edhe projekt-akti është përgatitur në dy variante, i kriterëve që duhet të plotësojë gjyqtari për t'u komanduar në vendin vakant. Referuar nenit 264 të ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në dy dispozita të veçanta parashikojnë kriteret të ndryshme në pamje të parë për pedagogët e brendshëm dhe për pedagogët e jashtëm. Për pedagogët e brendshëm ligji parashikon si kriter që të kenë si eksperiencë pune mbi 15 vjet mbi 15 vjet si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat dhe eksperiencë mësimdhënieje si pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, mbi 10 vjet. Ndërkohë që, për pedagogët e jashtëm parashikon që duhet të ketë të njëjtat kriteret si pedagog i brendshëm dhe në rastet kur gjyqtari vjen nga rrethi i

gjqtarëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, mjafton një eksperiencë pune 10-vjeçare si dhe eksperiencia mësimdhënëse 5-vjeçare.

Njëri variant i projektvendimit parashikon si kriter për gjyqtarin në rastin konkret, duke qenë se bëhet fjalë për komandim si pedagog i brendshëm, vetëm kriterin e parashikuar nga pika 2 e nenit 264, pra afatin 15-vjeçar si jurist, bashkë me eksperiencën në punë 10-vjeçare, eksperiencë mësimdhënëse pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i brendshëm dhe i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës.

Varianti i dytë parashikon që veç këtij kriteri, procedura e komandimit të jetë e hapur edhe për ata gjyqtarë të tjerë që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës, por që kanë një eksperiencë pune si gjyqtar 10-vjeçare, bashkë me eksperiencën mësimdhënëse 5-vjeçare.

Logjika e përpunimit të dy projekt-akteve është e tillë që, për sa kohë ligji barazon në trajtim pedagogët e brendshëm bashkë me pedagogët e jashtëm do të ishte diskriminuese trajtimi i ndryshëm në lidhje me kriteret ligjore që duhet të plotësojë secili në secilin rast. Nga ana tjetër, vetë rregullorja e shkollës ka parashikuar një barazi trajtimi të kriterëve ligjore si për pedagogë të jashtëm ashtu edhe për pedagogë të brendshëm.

Në logjikën time, duke qenë se ligji parashikon mundësinë që për pedagogë të jashtëm mund të aplikojnë edhe kandidatët që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës dhe kanë një eksperiencë pune mbi 10 vjet plus eksperiencë mësimdhënëse 5 vjet, nuk ka asnjë pengesë që ky kriter të zbatohet edhe për pedagogët e brendshëm, për të mos qëndruar thjesht në një zbatim formal të ligjit, por duke patur frymën që si kandidatët që aplikojnë për pedagogë të brendshëm dhe për pedagogë të jashtëm, duhet të kenë barazi në trajtim dhe duhet të kenë, në vlerësimin tim, duhet të plotësojnë të njëjtat kriterë ligjore.

Gjithsesi, kjo mbetet për t'u vlerësuar nga Këshilli.

Naureda Llagami: Kush e do fjalën?

Brunilda Kadi: Meqenëse s'kishte njeri për të folur. Në lidhje me këtë që diskuton Brikena dhe arsyeja pse janë sjellë dy variante, dhe unë në logjikën që parashitroi kolegja, jam dakord që ligji mund ta kishte parashikuar ndryshe, por në momentin që e ka parashikuar, unë mendoj që s'ka vend për interpretim, se ne nuk mund

të deformatojmë kriterin. Është qartazi e përcaktuar në dispozitë ligjore që për pedagogë të brendshëm duhet të kesh 15 vjet jurist, gjyqtar, prokuror. Kështu që, mendoj që këtu nuk ka vend për interpretim dhe unë jam për variantin e dytë, pa këtë kriter të deformuar, sipas meje, të ligjit. Faleminderit!

Fatmira Luli: Unë jam dakord që të përfshihet propozimi që bën Brikena për shkakun se në pikën 4 të dispozitës barazohen kushtet e pedagogut të jashtëm me ato të pedagogut të brendshëm, vetëm parashikohet një rast i veçantë, kur ai ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës kandidati ose kur punon aktualisht si gjyqtar, në këto kushte mendoj që s'mund të ketë barazim vetëm për të jashtëm, por ky rregull duhet të jetë edhe për pedagogët e brendshëm, për shkak se s'mund të kërkohen kushte të njëjta për rastin e pedagogut të jashtëm, që është shumë më pak i rëndësishëm, por që i vihet rëndësi faktit që ai punon gjyqtar dhe ka eksperiencën aktuale të punës dhe njëkohësisht ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës, e cila përbën një garanci më të lartë për kualifikimin e tij. Kështu që, mendoj që duhet të përfshihet pika 4.

Brikena Ukperaj: Atëherë, varianti i parë, për ta patur edhe më të lehtë, përfshin si kriteret, veç kriterit të parë të 15 vjet jurist, gjyqtar, prokuror dhe eksperiencë mësimdhënëse mbi 10 vjet; në pikën 4 përfshin edhe kriterin tjetër që duhet të jetë gjyqtar që ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës me një eksperiencë mbi 10 vjet dhe një eksperiencë mësimdhënëse 5 vjet. Ndërsa varianti i dytë është vetëm për kriterin ligjor, parashikuar nga 264 (neni 264), pika 2 e ligjit “Për organet e qeverisjes”.

Naureda Llagami: Mendoni që duhet ta kalojmë për votim?

Do hedhim në votim variantin e parë të projektvendimit në të cilin parashikon që gjyqtari në detyrë që kandidon për komandim në pozicionin e mësipërm duhet të ketë një “...eksperiencë pune mbi 15 vjet si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat dhe eksperiencë mësimdhënieje si pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, mbi 10 vjet”. Ky është varianti që ne do hedhim. Po, pika 4: “Gjyqtari në detyrë që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe kandidon për komandim në pozicionin e mësipërm duhet të ketë eksperiencë mbi 10-vjeçare si gjyqtar dhe eksperiencë mësimdhënieje universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi 5 vjet.”

Kalojmë për votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë, hedhim për votim variantin e dytë sipas të cilit: “Gjyqtari në detyrë që kandidon për komandim në pozicionin e mësipërm duhet të ketë eksperiencë pune mbi 15 vjet si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat dhe eksperiencë mësimdhënieje si pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, mbi 10 vjet.”

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Kundër.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, Këshilli miratoi projektvendimin “Për shpalljen e hapjes së procedurës për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës” sipas variantit të dytë të propozuar nga Komisioni përkatës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.02.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:14 dhe mbaroi në orën 16:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësuese e OSBE-së.*

RENDI I DITËS:

2. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Lidhur me këtë projektvendim, sikurse jeni në dijeni në vijim të mbledhjeve të mëparshme, në zbatim të rregullores së miratuar në mbledhjen e javës së kaluar, më datë 14.02.2019 Këshilli ka miratuar disa rregulla lidhur me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat e tjera. Për këtë arsye, Komisioni i Karrierës ka trajtuar 180 kërkesat dhe për më shumë detaje ia kaloj fjalën zotit Ilir Toska, kryetar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019 për rregullat dhe proceduat e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar kërkesave të paraqitura deri më sot, kemi

përgatitur relacionet përkatëse për të gjitha çështjet që gjykatat kanë paraqitur kërkesa për caktimin e një gjyqtari apo dy apo tre gjyqtarëve.

Kemi bërë një propozim lidhur me radhën e procedurave të shortit sipas gjykatave që do deshëm që fillimisht Këshilli ta miratojë apo jo dhe më tej, për çdo relacion i cili ka në vetvete edhe propozimet respektive për gjykatat nga duhet të caktohen gjyqtarët apo numrin e tyre, do duhet që Këshilli paraprakisht të miratojë propozimet dhe më tej duhet të ndjekim procedurat e shortit sipas hapave që kemi evidentuar në relacionet respektive.

Nëse jeni okej me këtë procedurë, fillimisht duhet të miratojmë radhën e procedurave të shortit sipas gjykatave. Është një akt i veçantë/një relacion i veçantë ku evidentohet që fillimisht të bëjmë shortin për gjykatat e apeleve, fillimisht për Gjykatën e Apelit për Krimet e Renda;

-Pastaj për gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, ku fillimisht Gjykata e Apelit Tiranë; më pas apeli Korçë; apeli Shkodër; apeli Gjirokastrë; apeli Durrës dhe në fund apeli Vlorë;

-Më tej kemi grupin e çështjeve që janë në nevojë nga gjykatat e shkallës së parë, fillimisht të hidhet shorti për Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Renda;

-Pastaj gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, fillimisht ato nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe më konkretisht, fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, më pas Kurbin, Mat dhe në fund Dibër;

-Më tej gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë: që është vetëm gjykata Pogradec që ka paraqitur kërkesë në nevojë;

-Më tej gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër: që janë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Pukë dhe Tropojë;

-Më tej gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë: fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, më pas Sarandë dhe në fund Përmet;

-Më tej Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës: fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe më tej ajo e Kavajës.

Dhe shorti i fundit që do ndjekim janë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, që kemi propozuar sipas kësaj radhe: fillimisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, më pas Korçë, Shkodër, Vlorë dhe në fund ajo e Tiranës.

Nëse Këshilli është dakord me këtë radhë të procedurave të shortit, ftoj që ta miratojë dhe ne fillojmë menjëherë sipas relacioneve përkatëse.

Naureda Llagami: Okej!

Atëherë, jemi dakord me radhën e propozuar nga...

Maksim Qoku: Të bëj vetëm një pyetje.

Naureda Llagami: Po!

Maksim Qoku: A të bëj një pyetje të lutem, vetëm tek kjo e fundit, tek Gjykata Administrative, pse është gjykuar që të jetë Tirana e fundit? Çfarë keni patur parasysh? Tek pika III Gjykata e Shkallës së Parë juridiksioni administrativ, keni bërë një radhë, dhe është Tirana në fund. Thjesht të di cili është... çfarë keni pasur parasysh që e keni bërë?

Ilir Toska: Kemi pasur parasysh ato hapat që kemi propozuar për shortet. Kemi konsideruar që Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vetëm 1 çështje, ndërkohë që nga gjykata e shkallës së parë duhet të caktohen ndërkohë gjyqtarë për gjykata të tjera të cilat kanë nevojë, që ato kanë më tepër numër çështjesh. E fundit është Tirana, jo për nga rëndësia, por për faktin se ka vetëm 1 çështje që duhet të delegohet 1 gjyqtar.

Naureda Llagami: Jeni dakord?

Ta hedhim në votim?

Hedhim në votim propozimin e bërë nga zoti Ilir Toska për radhën e gjykatave.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Propozimi miratohet.

Kalojmë në zhvillimin e procedurës së shortit.

Ilir Toska: Atëherë, sa kohë u miratua radha e procedurave të shortit, duhet të fillojmë sipas gjykatave që kemi propozuar. Do t'ju kërkoja që unë të asistoj pranë stafit meqenëse është mënyrë e re e të hedhurit të shortit, e ndryshme nga herët e tjera, që të ndihmoja për të kuptuar të gjithë hapat që ne kemi bërë me dije, duke i evidentuar me shkrim. Faleminderit!

Atëherë, do fillojmë me procedurën për shortin për **Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda**. Keni një relacion përkatës për këtë. Në këtë rast, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar, përveç gjyqtarët që propozohen të përjashtohen nga shorti, janë propozime konkrete për gjykatën nga vijnë dhe për numrin e gjyqtarëve. Kemi konsideruar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë. Po kështu kemi propozuar që numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e tre çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3. Nëse këshilli është dakord me këtë propozim, do të vazhdojmë me hapat që kemi propozuar.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Nga Gjykata e Apelit Tiranë kemi propozuar që përzgjedhja...

Naureda Llagami: Ndërkohë që Këshilli miratoi me dorë të ngritur propozimin e bërë nga kryetari i Komisionit, lidhur me mënyrën se si do të procedohet.

Ilir Toska: Atëherë, 3 gjyqtarët që kemi propozuar që të përzgjidhen nga Gjykata e Apelit Tiranë, kemi propozuar që të zgjidhen nga Seksioni Penal i Gjykatës së Apelit Tiranë. Për këtë, fillimisht duhet të bëjmë short që nga të gjithë gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, të përzgjedhim 3 prej tyre, ku përzgjedhja e një gjyqtari, automatikisht konsideron përzgjedhjen edhe të dy anëtarëve sipas trupave gjykues të asaj gjykate.

Përrjashtohen nga procedurat e shortit gjyqtarët që iu është akorduar leje afatgjatë: {....}, {....}; anëtari i KED-së, {....}; kryetari në detyrë, zoti {....} dhe; gjyqtarja {....}, që jemi informuar që është me raport mjekësor prej disa javësh. Nga ana tjetër, për 1 çështje gjyqësore konkrete, kanë pengesë ligjore dy gjyqtarët e kësaj gjykate, {....} dhe {....}.

Naureda Llagami: Jeni dakord për përjashtimin e tyre?

Ngrini dorën!

Të gjithë dakord.

Ilir Toska: Atëherë, në Seksionin Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë janë 9 gjyqtarë, që është përjashtuar vetëm gjyqtarja {....}. Kështu që shortin do ta hedhim për 8 gjyqtarë,

(Emri i parë i përzgjedhur është gjyqtarja {....}.)

Valbona Bako: Emri i parë, {....}.

Atëherë, {....} është gjyqtarja që u përzgjedh nga shorti. I bie që 2 anëtarët e tjerë do të jenë anëtarët që janë në trup gjykues me {....} në Seksionin Penal në Gjykatën e Apelit Tiranë, që referuar informacionit të Gjykatës së Apelit Tiranë, janë gjyqtarët {....} dhe {....}.

Atëherë, për çështjen nr. 3 përzgjidhen si gjyqtarë që duhet të gjykojnë atë çështje, gjyqtarët {....}, {....} dhe {....}. Gjyqtare {....} është njëkohësisht edhe gjyqtarja relatore që u përzgjedh e para.

Duhet të vazhdojnë procedurat e shortit për dy çështjet e tjera. Procedura e shortit, kemi propozuar që të përzgjidhen nga dy gjyqtarët që janë anëtarë, pra jo zonja {....}, por midis zotit {....} dhe zonjës {....}. Do të fusim në një enë dy çështjet që kërkohet caktimi i një gjyqtari dhe në enën tjetër emrat e dy gjyqtarëve. Gjyqtari i përzgjedhur i pari do marrë çështjen e parë dhe automatikisht, gjyqtari që mbetet do marrë çështjen e dytë. Janë çështjet me nr. 2 dhe nr. 3 *(lapsus, pasi çështjet janë nr. 1 dhe nr. 2.)*

Atëherë, do të përzgjedhim një çështje dhe pastaj do të zgjedhim një gjyqtar.

Çështja nr. 2. (Do përzgjidhet emri i gjyqtarit.)

Valbona Bako: Gjyqtarja {....}.

Ilir Toska: Po! Për çështjen nr. 2, që kërkon caktimin e një gjyqtari, zgjidhet gjyqtarja {....}. Automatikisht, për çështjen nr. 3 *(lapsus, pasi flitet për çështjen nr. 1)*

përzgjidhet gjyqtari që mbetet, çështja nr. 1, mbetet gjyqtari {...}. Kështu mbyllet procedura për Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Vazhdojmë me procedurën për caktimin e gjyqtarit në **Gjykatën e Apelit Tiranë**. Kërkohe vetëm për 1 çështje, kërkohen 3 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen të jetë 3 (tre). Përfshihen nga shorti zoti {...} që është anëtar i KED dhe zoti {...} që është kryetari i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Jeni dakord, të vazhdojmë me procedurën?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë do fusim në një enë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, përjashtuar zotin {...} dhe {...}. Janë emrat e 9 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Do zgjedhim 3 prej tyre.

{...} është gjyqtari i parë. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nuk ka ndarje në trupa gjyqësor, prandaj jemi të detyruar të zgjedhim 3 gjyqtarë.

{...} është gjyqtari i dytë.

{...} është gjyqtari i tretë.

Pra për çështjen që kërkohet nga Gjykata e Apelit Tiranë janë 3 gjyqtarët {...} (që është edhe relatori i çështjes), {...} dhe {...}. Kështu mbyllet shorti edhe për caktimin e gjyqtarëve për Gjykatën e Apelit Tiranë.

Do vazhdojmë për caktim gjyqtari për **Gjykatën e Apelit Korçë**. Gjykata e Apelit Korçë ka 51 kërkesa për çështje të caktuara: 35 kërkohen nga 1 gjyqtar, 7 çështje kërkohen 3 gjyqtarë dhe 9 çështje kërkohen 2 gjyqtarë. Atëherë, kemi propozuar që gjykatat nga duhet të caktohen gjyqtarët për të gjykuar çështjet e veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, të jenë nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, nga Gjykata e Apelit Durrës dhe nga Gjykata e Apelit Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 51 çështjeve gjyqësore, të jenë 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, 6 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Durrës dhe 6 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Tiranë (Seksioni Civil). Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, vazhdojmë me hapat e shortit. Fillimisht do të identifikojmë gjyqtarët sipas tre gjykatave që kemi propozuar, fillimisht Gjykata e Apelit Gjirokastrë, 6 gjyqtarë dhe do zgjedhim 3 prej tyre. Do fusim në një enë emrat e 6 gjyqtarëve sepse kemi propozuar që edhe kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë të jetë i përfshirë në short për shkak se është anëtar i një prej dy trupave gjykues që ka Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Kështu që s'mund ta përjashtojmë dot nga shorti. Në këtë enë u futën emrat e 6 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Do të përzgjedhim njërin emër, i cili automatikisht do të përcaktojë edhe emrat e dy anëtarëve të tjerë që janë në përbërje të trupit gjykues.

{....} është gjyqtari i përzgjedhur nga shorti, që është në përbërje të trupit gjykues bashkë me gjyqtarët {....} dhe {....}. Pra treshja e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë që do gjykojë në Gjykatën e Apelit Korçë është: {....}, {....} dhe {....}.

Për Gjykatën e Apelit Durrës kemi propozuar që të jenë 6 gjyqtarë. Sot efektivisht Gjykata e Apelit Durrës ka 7 gjyqtarë. Kemi propozuar që kryetari të përjashtohet nga shorti. Kështu që praktikisht të 6 gjyqtarët që mbeten të Gjykatës së Apelit Durrës, i bie që t'i konsiderojmë për t'i ngarkuar në çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë. Atëherë, emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës janë: {....}, {....}, {....}, {....}, {....} dhe {....}. Këta janë 6 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit (*Durrës*) që do gjykojnë çështje të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë.

Do përzgjedhim edhe 6 gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë që do gjykojnë për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë. Do të fusim emrat e të gjithë gjyqtarëve të Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke përjashtuar gjyqtarin {....}, {....}, {....}, {....}. Janë 15 gjithsej në Seksionin Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke hequr edhe ata gjyqtarë që ju thashë më sipër, kanë mbetur 11 gjyqtarë nga të cilët duhet të përzgjedhim 6 gjyqtarë për t'i caktuar në çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë. Zgjedhim njërin dhe automatikisht janë të përzgjedhur edhe dy të tjerët sipas trupave gjykues.

(Përzgjidhet gjyqtari {....}.)

{....}, {....} dhe {....}. Kjo është treshja që do caktohet nga Gjykata e Apelit (njëra treshe) dhe një treshe tjetër.

(Përzgjidhet gjyqtarja {...}.)

{...} u caktua.

(Përzgjidhet gjyqtarja {...}.)

{...} është në përbërje të trupit gjykues bashkë me {...} dhe {...}. Kjo është edhe treshja e dytë nga Gjykata e Apelit Tiranë që do gjykojë për llogari të Gjykatës...

Tani që përzgjedhëm gjyqtarët, do vazhdojmë për çështje të veçanta. Fillimisht kemi propozuar që të zgjedhim për 35 çështje ku kërkohet caktimi i një gjyqtari. Për 35 çështje kemi bërë dy nën-shorte: fillimisht për 30 çështje duke i ndarë dy çështje sipas rendit në listë dhe nga 15 gjyqtarët do marri secili nga 2 çështje dhe për 5 çështje që mbeten do bëhet shorti mes 15 gjyqtarëve. Do ndajmë dy çështjet sipas renditjes në listë me grupe dyshe. Po t'i referohemi listës, çështjet që kërkohet caktimi i 1 gjyqtari është: 1-2, 3-4, 6-7, 9-10, 11-12, 13-14, 15-16, 17-19, 21-24, 25-26, 27-28, 30-33, 34-35, 36-41, 42-43 (15 çifte). Do futen emrat e 15 gjyqtarëve tek vazo tjetër (3 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, 6 të Durrësit dhe 6 të Tiranës që i përzgjedhëm më herët). Vazhdojmë shortin për ndarjen e 30 çështjeve që kërkohet nga 1 gjyqtar. Do përzgjedhim çiftin e çështjeve të para, pastaj do përzgjedhim gjyqtarin respektiv.

Për çështjet 27-28, do përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Vazhdojmë me një grup tjetër çështjesh.

Për çështjet 42-43, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 6-7, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 30-33, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 3-4, përzgjedhim gjyqtarin – {...}.

Për çështjet 11-12, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 34-35, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 36-41, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 15-16, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 1-2, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 9-10, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 25-26, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 17-19, përzgjedhim gjyqtarin që është – {...}.

Për çështjet 21-24, përzgjedhim gjyqtarin që është – {....}.

Për çështjet 13-14, do përzgjedhim gjyqtarin që është – {....}.

Kanë ngelur edhe 5 çështje që kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Janë çështjet e renditura në fund të listës: 51-shi, 50-a, 49-a, 47-a dhe 44-a. Në një enë do fusim emrat e 15 gjyqtarëve, kurse tek ena tjetër do fusim numrat e pesë çështjeve që përmenda më lart.

Vazhdojmë procedurën për 5 çështjet ku kërkohet caktimi i 1 gjyqtari që do t'i hedhim në short përmes 15 gjyqtarëve.

Për çështjen me nr. 44 përzgjidhet gjyqtari që është - {....}.

Çështja me nr. 47 përzgjedhim gjyqtarin - {....}.

Çështja me nr. 49 përzgjedhim gjyqtarin - {....}.

Çështja me nr. 51 – përzgjedhim gjyqtarin - {....}.

Dhe çështja e fundit që kërkohet caktimi i 1 gjyqtari me nr. 50 përzgjedhim gjyqtarin që është – {....}.

Mbaruam me 51 çështjet për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Do të vazhdojmë me çështjet për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. Kemi 7 çështje për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. Dy çështje, ato me nr. 22 dhe 23, janë me objekt: “Përjashtim gjyqtari”, janë kërkesa të përsëritura për “Përjashtim gjyqtari” brenda së njëjtës çështje, ku më herët KLD ka deleguar 3 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Këta gjyqtarë kanë qenë {....}, {....} dhe {....}. Është kërkuar/propozuar edhe nga kryetari i Gjykatës së Apelit Korçë që të njëjtat kërkesa brenda së njëjtës çështje, që kanë të njëjtin objekt: “Përjashtim gjyqtari”, të jenë të njëjtët gjyqtarë që kanë gjykuar edhe më herët: {....}, {....} dhe {....}. Jeni dakord që të caktohen po këta gjyqtarë për gjykimin e dy kërkesave për “Përjashtim gjyqtari” brenda së njëjtës çështje?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Faleminderit!

Vazhdojmë atëherë shortin për 5 çështjet e tjera për të cilat kërkohen 3 gjyqtarë (çështjet nr. 31, 32, 38, 39 dhe 48) të cilat do ndahen mes 5 trupave gjykues që kemi përzgjedhur më herët: 1 trup gjykues i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, 2 të apelit Durrës dhe 2 të Apelit Tiranë.

Do fusim në një enë çështjet me nr. 31, 32, 38, 39 dhe 48, kurse në krahun tjetër do të fusim të grupuar bashkë trupat gjykues 1 trup gjykues i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, 2 të apelit Durrës dhe 2 të Apelit Tiranë. Do t'i gruponi sipas trupave gjykues.

Atëherë vazhdojmë shortin për ndarjen e 5 çështjeve që kërkohen 3 gjyqtarë.

Po zgjedhim një të çështje.

Për çështjen nr. 31 caktohet për ta gjykuar trupi gjykues që përbëhet nga gjyqtarët – {....}, {....} dhe {....}.

Vazhdojmë me çështjen tjetër.

Çështja nr. 32, përzgjedhim trupin gjykues, përbëhet nga gjyqtarët – {....}, {....} dhe {....}.

Çështja nr. 48, përzgjedhim trupin gjykues, përbëhet nga gjyqtarët – {....}, {....} dhe {....}.

Çështja nr. 39, përzgjedhim trupin gjykues që përbëhet nga gjyqtarët – {....}, {....} dhe {....}.

Dhe çështja e fundit me nr. 38 përzgjedhim përbërjen e trupit gjykues që përbëhet nga gjyqtarët – {....}, {....} dhe {....}.

Tani, për secilën nga këto çështje do të zgjedhim relatorin dhe do ta mbyllim.

Atëherë për çështjen nr. 31 do zgjedhim gjyqtarin relator që është mes {....}, {....} dhe {....}, do të zgjedhim njërin prej tyre për relator – është gjyqtari {....}. Për çështjen nr. 31, relator është gjyqtari {....}, anëtarë: {....}, {....}.

Për çështjen nr. 32 do zgjedhim relatorin – relator për çështjen nr. 32 është {....} dhe anëtarë: {....} Dhe {....}.

Për çështjen nr. 48 do zgjedhim gjyqtarin relator – është {....}, anëtarë janë: {....} dhe {....}.

Për çështjen nr. 38 do zgjedhim relatorin – relator është {....}, anëtarë janë: {....} dhe {....}.

Dhe çështja e fundit 39-a do zgjedhim gjyqtarin relator - relator është {....}, anëtarë janë {....} dhe {....}.

Do vazhdojmë për 9 çështjet që kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Janë 5 çështjet e para, do t'i zgjedhim sipas trupave gjykues. Çështjet janë 5, 8, 18, 20 dhe 29.

Vazhdojmë shortin për caktimin e 2 gjyqtarëve për 5 çështje për të cilat kërkohen 2 gjyqtarë. Këto 5 çështje janë me nr. 5, 8, 18, 20 dhe 29.

Përzgjedhim 1 çështje dhe përzgjedhim trupin gjykues nga duhet të...

Çështja nr. 5_gjyqtarët duhet të jenë nga trupi gjykues që përbëhet nga - {...}, {...}, {...}.

Për çështjen 20 përzgjedhim trupin gjykues nga duhet të përzgjidhen dy gjyqtarët, që janë – {...}, {...}, {...}.

Për çështjen 18 përzgjedhim trupin gjykues nga duhet të përzgjidhen dy gjyqtarët, që janë – {...}, {...} dhe {...}.

Për çështjen 29 përzgjedhim trupin gjykues nga duhet të përzgjidhen dy gjyqtarët, që janë – {...}, {...} dhe {...}.

Dhe për çështjen nr. 8 trupi gjykues është ai i përbërë nga - {...}, {...} dhe {...}.

Vazhdojmë për secilin nga këto të përzgjedhim 2 gjyqtarë.

Për çështjen nr. 5 do të përzgjedhim 2 nga anëtarët e trupit gjykues.

Për çështjen nr. 5 përzgjidhet gjyqtarja - {...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 20 përzgjidhen gjyqtarët - {...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 18 përzgjidhen gjyqtarët - {...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 29 përzgjidhen gjyqtarët - {...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 8 përzgjidhen dy gjyqtarët – {...} dhe {...}.

Vazhdojmë shortin për 4 çështjet e tjera për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, që janë çështjet me nr. 37, 40, 45, 46.

(Ripërsëritet e njëjta procedurë.)

Zgjedhim njëren nga çështjet.

Për çështjen nr. 37 përzgjedhim trupin gjykues nga duhet të zgjedhim 2 gjyqtarë, që janë nga trupi gjykues që përbëhen nga – {...}, {...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 46 përzgjedhim trupin gjykues nga duhet të zgjedhim 2 gjyqtarë, që janë – {...}, {...}, {...}.

Për çështjen nr. 45 përzgjedhim trupin gjykues nga duhet të përzgjidhen 2 gjyqtarë, që janë – {....}, {....} dhe {....}.

Dhe për çështjen e fundit që është me nr. 40, përzgjedhim trupin gjykues që është – përbëhet nga gjyqtarët {....}, {....} dhe {....}.

Tani do zgjedhim 2 gjyqtarët mes këtyre trupave gjykues.

Për çështjen nr. 37 do përzgjedhim 2 gjyqtarë nga tre anëtarët e trupit gjykues - ata janë gjyqtarët {....} dhe {....}.

Për çështjen nr. 40 përzgjedhim 2 nga gjyqtarët e trupit gjykues - ata janë gjyqtarët {....} dhe {....}.

Për çështjen nr. 45 përzgjedhim 2 gjyqtarët e trupit gjykues - që janë {....} dhe {....}.

Dhe për çështjen e fundit 46 përzgjedhim 2 nga anëtarët e trupit gjykues – që janë {....} dhe {....}.

Kështu mbaruam edhe Gjykatën e Apelit Korçë.

Vijojmë me **Gjykatën e Apelit Shkodër**. Në Gjykatën e Apelit Shkodër kërkohet caktimi i gjyqtarit në 7 çështje gjyqësore. Në 4 çështje - 1 gjyqtar, në 2 çështje – 3 gjyqtarë dhe në 1 çështje – 2 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjyqtarët që duhet të caktohen në Gjykatën e Apelit Shkodër të jenë nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Kurse numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet, të jetë 6 të tillë. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë atëherë me hapat e shortit.

Për 4 çështjet penale kemi propozuar që gjyqtarët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Për çështjen penale nr. 1 për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, do të përzgjedhim nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, duke përjashtuar kryetarin e gjyqtarës, zotin {....} dhe anëtarin e KED, {....}. Mes 11 gjyqtarëve do të përzgjedhim 3 gjyqtarë, të cilët ngarkohen për të shqyrtuar çështjen penale nr. 1. Ndërkohë që gjyqtari që do të përzgjidhet i pari, do të jetë njëkohësisht edhe relatori i çështjes. Atëherë përzgjedhim fillimisht 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda. Do të fusim emrat e 9

gjqtarëve dhe do të përzgjedhim 3 prej tyre - ata janë {....}, {....} dhe {....}, ndërkohë {....} si gjyqtarja e përzgjedhur e para, është edhe relatorja e çështjes penale nr. 1 për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë.

Për tre çështjet e tjera penale të Gjykatës së Apelit Shkodër, ato 2, 3 dhe 4 për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, do të përzgjidhen me short mes 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda që u përzgjedhën më herët. Do fusim çështjen nr. 2, 3 dhe 4.

Atëherë, për çështjen nr. 2 përzgjedhim gjyqtarin – është {....}.

Për çështjen nr. 3 përzgjedhim gjyqtarin – që është {....}.

Për çështjen nr. 4 përzgjedhim gjyqtarin – që i mbetet të jetë {....}.

Tani janë 3 çështje civile që duhet të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, nga tre prej tyre duhet të bëjmë short për të përzgjedhur 3 gjyqtarë. Nga shorti duhet të përjashtohen gjyqtarët që janë me leje, {....}, {....}, {....} si anëtar i KED, kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, {....}, si dhe 6 gjyqtarët që u përzgjedhën më herët nga Seksioni Civil i Gjykatës së Apelit Tiranë që u ngarkuan për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Korçë. Këta duhet të përjashtohen nga shorti.

Do përzgjedhim 3 prej tyre (*lista me gjyqtarët e mbetur të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Nëse krijohet trupi gjykues me gjyqtarin që do përzgjedhim të parin, do shkojë bashkë me trupin gjykues, nëse jo, do të vazhdojmë procedurën.

{....} (*i përzgjedhuri i parë*).

Kë ka në trup gjykues?

Okej, atëherë treshja është {....}, {....} dhe {....}. Këto janë gjyqtarët që janë përzgjedhur për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe automatikisht për çështjen nr. 7 për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë. Janë këta 3 gjyqtarët e përzgjedhur, pra {....}, {....} dhe {....} dhe relator është gjyqtari që u përzgjedh i pari, që është {....}.

Janë edhe dy çështje të tjera civile për të cilat kërkohet 1 gjyqtar dhe shorti do hidhet mes këtyre 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë. Janë çështjet 5 dhe 6 që duhet të futen në një enë dhe emrat e tre gjyqtarëve që duhet të hyjnë tek ena tjetër.

Po, 5-a dashka 2.

Atëherë, për 5 duhet të zgjedhim 2 gjyqtarë dhe për 6...

Për çështjen nr. 5 do zgjedhim emrat e 2 gjyqtarëve, mes 3 që zgjodhëm më herët – janë {....} dhe {....}.

Për çështjen nr. 6 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, do zgjedhim njërin prej 3 gjyqtarëve që zgjodhëm më herët.

Për çështjen nr. 6, gjyqtari i zgjedhur nga shorti është {....}.

Kështu mbaroi edhe apelit Shkodër.

Vazhdojmë **me apelin Gjirokastrë.**

Apeli Gjirokastrë ka 7 çështje. Kërkohen në 4 çështje – 3 gjyqtarë; në 2 çështje – 1 gjyqtar dhe 1 çështje – 2 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen të jetë Gjykata e apelit Korçë dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen, të jetë 5. Jeni dakord me këtë?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, për çështjen nr. 3, me objekt: “Caktim institucioni që ngarkohet me pagesën e shpenzimeve gjyqësore të bëra në procesin penal”, kemi propozuar që gjyqtarët që duhet të caktohen të jenë po ata gjyqtarë të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, të cilët janë përzgjedhur më parë me short nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që kanë gjykuar çështjen në themel dhe kanë dhënë vendimin me të cilin është disponuar për shpenzimet gjyqësore në procesin penal, për të cilin kërkohet caktimi i institucionit që këto shpenzime i janë ngarkuar. Referuar për këtë edhe informacionit të bërë edhe nga kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Këta gjyqtarë janë {....} dhe {....}.

Jeni dakord që këta 2 gjyqtarë të caktohen për të gjykuar këtë çështje?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Mirë atëherë, do vazhdojmë shortin për përzgjedhjen e çështjeve të tjera.

Për 4 çështje të tjera kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. Janë çështjet 2, 5, 6 dhe 7 që duhet të përzgjidhen midis 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë. Duhet të përzgjedhin 3 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Korçë fillimisht, se Gjykata e Apelit Korçë ka 4 gjyqtarë dhe kemi propozuar që kryetarja e Gjykatës së Apelit Korçë të mos përjashtohet nga shorti, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve dhe nuk ka trupa gjykues të përcaktuar.

Atëherë, emrat e 4 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, për të përzgjedhur 3 prej tyre. Atëherë, emrat e 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë që do të gjykojnë për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë janë: {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë, kemi 4 çështje që kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. Do hedhim short fillimisht 3 çështje, për të cilat do të caktojmë relatorin. 3 çështjet e para janë: 2-shi, 5-a, 6-a (do i fusësh në një enë), në enën tjetër janë emrat e gjyqtarëve. Po përzgjedhim gjyqtarin që duhet të jetë relator për çështjen 2, 5, 6.

Atëherë, për çështjen 2, relator është gjyqtarja {...}.

Për çështjen 5, gjyqtar relator është {...}.

Për çështjen nr. 6, relator është gjyqtarja {...}.

Ka ngelur edhe një çështje tjetër, çështja nr. 7, për të cilën duhet të zgjedhim relatorin mes tre gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë. *(Pas përzgjedhjes)* Atëherë, gjyqtari relator për çështjen nr. 7 është {...}. Treshja është {...}, {...}, {...}, siç ishte për katër çështjet në tërësi.

Këtu mbaron edhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Durrës**.

Gjykata e Apelit Durrës ka nevojë për 2 çështje: në 1 çështje kërkohet 1 gjyqtar dhe në 1 çështje kërkohen 3 gjyqtarë.

Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen, të jetë Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen të jetë 3.

Për çështjen nr. 2 është me objekt: “Sqarim dhe interpretim vendimi”, gjyqtarët që duhet të caktohen kemi propozuar të jenë po ata gjyqtarë të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda të cilët janë përzgjedhur më parë me short nga ish-KLD dhe kanë gjykuar në themel çështjen dhe kanë dhënë vendimin objekt kërkese për sqarim dhe interpretim vendimi, referuar edhe informacionit të kryetarit të Gjykatës së Apelit Durrës. Këta gjyqtarë janë {...}, {...} dhe {...}. Jeni dakord me këtë?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Për çështjen tjetër, i bie që gjyqtarin ta përzgjedhim mes këtyre 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Në këtë rast kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Pra mes 3 gjyqtarëve si më lart, do zgjedhim njërin që do caktohet për çështjen nr. 1 – ai

është {...}. Pra për çështjen nr. 1 caktohet në Gjykatën e Apelit Durrës gjyqtari {...}, gjyqtar i Apelit për Krimet e Rënda.

Këtu mbarojmë edhe Gjykatën e Apelit Durrës.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Vlorë**.

Gjykata e Apelit Vlorë ka 15 çështje ku ka nevojë për gjyqtarë: 8 çështje kërkon 1 gjyqtar, 5 çështje kërkojnë 3 gjyqtarë dhe 2 çështje kërkojnë 2 gjyqtarë.

Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët të jetë Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda dhe numri i gjyqtarëve që duhet të përzgjidhen, të jetë 6.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë me procedurat e shortit.

Fillimisht për çështjet për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. Do përzgjedhim 6 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, duke hequr gjyqtarin {...}, kryetar i gjykatës dhe gjyqtarin {...}, që është anëtar i KED. Nga 9 gjyqtarë duhet të përzgjedhim 6 gjyqtarë – ata janë {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Do çiftohen 1-2 bashkë, 3-4 bashkë.

Do përzgjedhim për secilin nga këto çifte çështjesh 3 gjyqtarë.

Për çështjet me nr. 1-2 përzgjedhim gjyqtarët që janë – {...} që është edhe relatore e çështjes, {...} dhe {...}.

3-4 janë 3 gjyqtarët e tjerë – {...}, {...} dhe {...}. Gjyqtari {...} automatikisht është edhe relator për çështjen nr. 3.

Bëjmë edhe relatorin për çështjen 4, që të shpërndajmë ngarkesën e punës. Për çështjen 4 bëhet short duke hequr gjyqtarin {...} – është {...}. Pra për çështjen nr. 4 relatore është {...}, anëtarë janë: {...} dhe {...}.

Ndërsa për çështjen nr. 1 thamë që gjyqtarja {...} është edhe relatore. Bëjmë për çështjen nr. 2 mes {...} {...}, kush do të jetë relator. Për çështjen nr. 2 relator është gjyqtarja {...}.

Është edhe çështja nr. 5 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, do fusim 6 gjyqtarët, do përzgjedhim tre prej tyre.

(Çështja që shorohet në vijim është çështja nr. 8 sipas relacionit, ku kërkohen 3 gjyqtarë.)

Atëherë, {...} është gjyqtarja e përzgjedhur e parë për çështjen nr. 5 (*lapsus, çështja nr. 8*) që i bie të jetë edhe relato e çështjes. Anëtarë janë {...} dhe {...}. Pra çështja nr. 8 {...} është relato e, {...} dhe {...} janë anëtare.

Vazhdojmë me çështjet për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve që janë çështjet nr. 13, 14. Atëherë 13, 14 kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve.

Për çështjen nr. 13 përzgjedhim 2 gjyqtarë – që janë {...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 14 përzgjedhim 2 gjyqtarë – që janë {...} dhe {...}.

Janë edhe 8 çështje që kërkohet 1 gjyqtar. Do hedhim fillimisht 6 çështjet e renditura të para në listë, që të marrin 6 nga gjyqtarët nga 1 çështje dhe pastaj do hedhim dy çështjet e tjera mes 6 gjyqtarëve.

Çështjet për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar janë çështjet nr. 5, 6, 7, 9, 10, 11.

(*Futen në një enë çështjet dhe ne krahun tjetër 6 gjyqtarë.*)

Çështja nr. 6, gjyqtari që përzgjidhet nga shorti është – {...}.

Për çështjen nr. 7, gjyqtari që përzgjidhet nga shorti është – {...}.

Për çështjen nr. 9, gjyqtari që përzgjidhet nga shorti është – {...}.

Për çështjen nr. 10, gjyqtari që përzgjidhet është – {...}.

Për çështjen nr. 5, gjyqtari që përzgjidhet është – {...}.

11-a është gjyqtari – {...}.

Janë edhe 3 çështje të tjera që kërkohet caktimi i 1 gjyqtari që janë me nr. 15 dhe 12 dhe 11. Jo! Ah e bëmë. 12 dhe 15 (2 çështje).

Për çështjen 12 gjyqtari është – {...}.

Dhe për çështjen nr. 15 gjyqtari është – {...}.

Këtu mbaron edhe shorti për Gjykatën e Apelit Vlorë dhe për të gjithë gjykatat e apelit.

Vazhdojmë me shortin për **Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda**.

Janë 3 çështje ku kërkohet caktim gjyqtari. Në 1 çështje kërkohen 2 gjyqtarë dhe në 2 çështje nga 1 gjyqtar. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen të jetë Gjykata e

Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet të jetë 2 nga Seksioni Penal i kësaj gjykate. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë! Atëherë, të marrim gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të Seksionit Penal.

Cështja nr. 1 kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Kemi futur në një enë emrat e të gjithë gjyqtarëve të Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe do të përzgjedhim 2 prej tyre që do të jenë anëtarë në çështjen nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve – ata janë {...} dhe {...}.

Janë 2 çështje të tjera për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, që janë çështja me nr. 2 dhe nr. 3, që kemi propozuar të zgjidhen mes këtyre 2 gjyqtarëve (njëri në një rast dhe tjetri në rastin tjetër). Të fusim në një enë numrin 2 dhe 3 dhe në enën tjetër emrat e këtyre gjyqtarëve.

Zgjedhim për çështjen 2 dhe 3 gjyqtarin respektiv. Për çështjen nr. 2 zgjidhet gjyqtari Sokol {...}.

(Zonja Ukperaj pyet nëse gjyqtarja {...} ka 5 vite eksperiencë.)

Atëherë, anulojmë shortin. Bëjmë short nga e para. Duhet përjashtuar. Atëherë do të përzgjedhim edhe një herë. {...} dhe duhet të përzgjedhim edhe një gjyqtar tjetër për shkak se gjyqtarja {...} nuk mund të marri pjesë, nuk mund të caktohet në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda – {...}. Atëherë, për çështjen nr. 1 caktohen dy gjyqtarë të Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: {...} dhe {...}.

Mes këtyre dy gjyqtarëve do të zgjedhim për secilën nga dy çështjet e tjera, 2-shin, 3-shin që kërkohet vetëm 1 gjyqtar.

Për çështjen nr. 3 zgjidhet gjyqtar {...} dhe për çështjen nr. 2 zgjidhet gjyqtarja {...}.

Mbaroi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Vazhdojmë me gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë. E para është **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**. Kërkohet caktim në 16 çështje. Në 15 çështje – 1 gjyqtar dhe 1 çështje – 3 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen gjyqtarët në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 16 çështjeve gjyqësore, të jetë 5 gjyqtarë. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Për 9 çështjet penale kemi propozuar që 3 gjyqtarët të caktohen nga Seksioni Penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke përjashtuar gjyqtarët që janë me leje {....}, {....}, kryetaren {....} dhe gjyqtarët e Seksionit Penal që u caktuan tek Gjykata e Krimeve të Rënda ({....} dhe {....}), po kështu duhet të përjashtohen edhe gjyqtarët që kanë pengesë ligjore për gjykimin e disa çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, që janë {....}, {....}, {....}.

3 gjyqtarët që do të përzgjidhen nga shorti për të gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë janë – {....}, {....}, {....}. Në këtë rast gjyqtari {....} është edhe relatori i çështjes nr. 3, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve.

Ndërkohë janë edhe 8 çështje të tjera penale ku caktimi për secilën nga ato do të bëhet midis 2 gjyqtarëve që janë përzgjedhur si anëtarë, duke përjashtuar {....}n që është relator. Do të bëjmë për 8 çështjet, grupe-grupe çështjet nga dy sipas listës (penale janë 1-2-4-5, 6-7-8-9 janë bashkë).

Përzgjedhim grupin e çështjeve. Atëherë, për çështjet 1-2-4-5 gjyqtari është – {....}. Për grupin e dytë të çështjeve 5-6-7-8 gjyqtari është - {....} (*lapsus numri i çështjeve, duhet 6-7-8-9*). Atëherë 1-2-4-5 është {....}; 6-7-8-9 është {....}.

Vazhdojmë, se janë edhe çështjet civile. Për 7 çështje civile kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Kemi propozuar që të caktohen 2 gjyqtarë nga Seksioni Civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Atëherë, përzgjidhen {....} dhe {....}.

Atëherë do bëjmë dy grupe çështjesh, njëri do ketë 4 çështje, tjetri 3. Njëri grup ka çështjet nr. 10, 11, 12, 14. Grupi i dytë është 13, 15, 16.

Përzgjedhim grupin e parë të çështjeve që janë 10, 11, 12, 14 dhe gjyqtarja është – {....}.

Grupi tjetër, çështjet me nr. 13, 15, 16 gjyqtarja është - {....}.

Kështu mbaron edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka kërkesa për 16 çështje: 15 çështje kërkon 1 gjyqtar dhe 1 çështje

kërkohen 2 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen gjyqtarët për të gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3 të tillë. Për 14 çështje penale caktohen 2 gjyqtarë nga Seksioni Penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa për 2 çështjet civile caktohet 1 i tillë.

Atëherë do të zgjedhim 2 gjyqtarë nga Seksioni Penal të cilët do të ngarkohen për gjykimin e 14 çështjeve penale pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Në këtë rast përjashtohen nga shorti gjyqtarët që janë me leje {...}, {...}, kryetarja e gjykatës {...}, gjyqtarët që janë caktuar më herët në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, që janë {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Duhet të përzgjedhim 2 gjyqtarë – {...} dhe {...}. Këta dy gjyqtarë do të ngarkohen për gjykimin e çështjes nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve.

Ndërkohë që janë edhe 13 çështje të tjera penale për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Do i ndajmë në dy grupe (njëri grup 6 dhe njëri grup 7) dhe do të zgjedhim secilin nga këto dy gjyqtarë për këto çështje sipas grupeve. Njëri grup është me çështjet 2, 3, 4, 5, 6, 7. Grupi tjetër është 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14.

Zgjedhim njërin grup çështjesh. Për grupin e çështjeve me nr. 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 përzgjidhet gjyqtari – {...}. Për grupin tjetër me çështjet nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7 përzgjidhet gjyqtari – {...}.

Kemi edhe 2 çështje civile ku kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, që kemi propozuar që të zgjidhet nga seksioni civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke përjashtuar gjyqtarët që kemi caktuar më herët në gjykatat e tjera. Do të përzgjedhim njërin prej tyre – {...}. Atëherë, gjyqtarja {...} caktohet për gjykimin e 2 çështjeve civile, ato me numër 15, 16. Këtu mbyllet edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Kemi **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka nevojë për 9 çështje, nga të cilat në 6 çështje duhet 1 gjyqtar dhe në 3 çështje duhen 2 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen gjyqtarët për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të gjykojnë 9 çështjet gjyqësore të jetë 3.

Kemi propozuar që të përjashtohet nga shorti kryetari i kësaj gjykate {....}. Duhet të jetë në ditët e fundit që mbush moshën 65 vjeç.

Atëherë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka gjithsej 4 gjyqtarë. Duke hequr kryetarin që është në prag pensioni, {....}, ngelen 3 gjyqtarë që janë – {....}, {....} dhe {....}. Mes këtyre tre gjyqtarëve do të ndahen çështjet që janë në nevojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Janë 3 çështje penale që kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Fusim numrat e çështjeve penale që kërkohet nga 2 gjyqtarë, janë me nr. 1, 3, 4.

Për çështjen nr. 3 gjyqtari që përzgjidhet është – {....}, {....}.

Për çështjen nr. 1 është – {....} dhe {....}.

Për çështjen nr. 4 është – {....} dhe {....}.

Janë 6 çështje të tjera ku kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Po i ndajmë në tre grupe dyshe: 2-5, 6-7 dhe 8-9. Për secilin grup çështjesh do zgjedhim 1 gjyqtar.

Atëherë për çështjet nr. 8-9 gjyqtari i përzgjedhur është {....}.

Për çështjen nr. 6-7 gjyqtari i përzgjedhur është – {....}.

Për çështjet nr. 2-5 gjyqtari i përzgjedhur është – {....}.

Me kaq mbaron edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Kemi **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka 2 çështje ku kërkohen në secilin prej tyre 2 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet të jetë 2. Dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë po përzgjedhim nga gjyqtarët e rrethit gjyqësor Mat 2 gjyqtarë – {....} dhe {....}. Në të dy çështjet gjyqësore të Dibrës që kërkohen nga 2 gjyqtarë, ata do të jenë {....} dhe {....}. Mbaroi edhe Dibra.

Vazhdojmë me juridiksionin e apelit Korçë, që është vetëm Gjykata e Pogradecit. Janë 7 çështje ku kërkohet caktim gjyqtari. Në 5 çështje kërkohet vetëm 1 gjyqtar dhe në 2 çështje kërkohen 2 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen gjyqtarët për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë me procedurat e shortit. Do të përzgjedhim gjyqtarët nga Seksioni Penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë që do gjykojnë 4 çështjet penale, ndërkohë për 3 çështjet civile do të përzgjedhim 1 gjyqtar nga Seksioni Civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë nuk ka përjashtime. Përjashtoj vetëm kryetarin... {....} është në penale? Do ta përjashtoni dhe do fusim vetëm emrat e gjyqtarëve të tjerë të Seksionit Penal, për të përzgjedhur 2.

Atëherë, 2 gjyqtarët e përzgjedhur janë – {....} dhe {....}. Të dy gjyqtarët caktohen për çështjet që kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve që janë 2 çështje 4-7.

Ndërkohë janë edhe 3 çështje të tjera penale për të cilat kërkohen nga 1 gjyqtar, dy çështje të tjera, janë 5-6 dhe duhet te hedhim shortin mes këtyre 2 gjyqtarëve për 5-ën dhe 6-ën.

Për çështjen nr. 6, gjyqtari që caktohet është {....}.

Ndërsa për çështjen nr. 5, gjyqtari që caktohet është {....}.

Vazhdojmë procedurën e shortit për sa i përket çështjes civile (janë 3 të tilla), duhet të përzgjedhim nga Seksioni Civil i rrethit gjyqësor Korçë 1 gjyqtar – {....}, e cila caktohet për të 3 çështjet civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjet që në listë mbajnë nr. 1, 2, 3. Me kaq mbyllet edhe procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Vazhdojmë për juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë**. Kërkohet caktimi i gjyqtarëve për 4 çështje (në 2 çështje 1 gjyqtar dhe në 2 çështje 2 gjyqtarë). Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen duhet të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen të jetë 2 të tillë, një nga Seksioni Penal dhe një nga Seksioni Civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Fillimisht po zgjedhim 1 nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe më pas 1 nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kryetari përjashtohet.

Ky është nga Seksioni Penal – është gjyqtari {....}.

Nga Seksioni Civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duhet të përzgjedhim një gjyqtar tjetër – është {....}. Atëherë, për çështjen nr. 1 dhe nr. 4 për të cilat kërkohen 2 gjyqtarë, gjyqtarët që janë përzgjedhur nga shorti janë {....} dhe {....}.

Ndërkohë janë edhe 2 çështje të tjera që kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, çështja nr. 2 dhe 3 që duhet të zgjidhet mes këtyre 2 gjyqtarëve.

Për çështjen nr. 2 gjyqtari i përzgjedhur është - {....}.

Ndërsa për çështjen nr. 3 gjyqtari i përzgjedhur është - {....}.

Me kaq mbaron Lezha.

Vazhdojmë **me Pukën**. Atëherë, Puka ka nevojë në 2 çështje (1 çështje duhet 2 gjyqtarë dhe 1 çështje duhet 1 gjyqtar). Kemi propozuar që gjyqtarët të caktohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Të caktohen 2 të tillë nga Seksioni Penal. Në këtë rast, përjashtohet përveç kryetarit edhe gjyqtari {....} që u caktuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Nga Seksioni Penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Rrethit Gjyqësor Shkodër duhet të përzgjedhim 2 gjyqtarë.

Atëherë, gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Rrethit Gjyqësor Shkodër janë {....} dhe {....}, të cilët caktohen për gjykimin e çështjes nr. 1, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë.

Të bëjmë shortin për çështjen e dytë që kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, që do të zgjidhet mes këtyre 2 gjyqtarëve – është {....}. Pra për çështjen nr. 2 në listë, gjyqtari që zgjidhet është {....}. Me kaq mbaron edhe Puka.

Vazhdojmë **me Tropojën**. Tropoja kërkon/ka nevojë në 7 çështje dhe nga 1 gjyqtar (6 penale dhe 1 civile). Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen gjyqtarët, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3. Atëherë, do të përzgjedhim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës 3 gjyqtarë. {....} duhet të përjashtohet.

Atëherë, gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës që duhet të gjykojnë çështjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë janë – {....}, {....} dhe {....}.

Kemi çështjet 1, 4, 7, janë çështje që kanë gjyqtarët pengesë ligjore. Duhet të përzgjedhim 2 prej tyre. Ka pengesë {....} tek 1, 4, 7?

Tek çështja nr. 7 – {....}. Ky përjashtohet se ka pengesë ligjore?

Të përzgjedhim një tjetër.

Është {...} – çështja nr. 7.

Për çështjen nr. 4 përzgjedhim – {...}. Ka pengesë ligjore.

Do të përzgjedhim një tjetër - {...}.

Dhe çështja e fundit 1, do të përzgjedhim një gjyqtar tjetër – {...} ka pengesë. Një tjetër – {...}. Të tria, ra {...}.

Janë edhe çështjet 2, 3 dhe 5 që s'ka pengesë asnjë nga gjyqtarët. Duhet të bëjmë të njëjtën procedurë.

Për 5-ën zgjidhet – {...}.

Për 3-shin zgjidhet – {...}.

Për 2-shin zgjidhet {...}.

Është edhe çështja e fundit që duhet të përzgjidhet mes këtyre tre gjyqtarëve.

{...} është e zgjedhura për short për çështjen nr. 6 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Rrethit Tropojë dhe me kaq mbyllet Tropoja.

Kemi **rrethin gjyqësor Gjirokastrë**. Ka nevojë në 4 çështje që janë penale (1 çështje duhen 2 gjyqtarë dhe në 3 çështje duhet 1 gjyqtar). Në një nga çështjet penale kërkohet që gjyqtari të jetë nga seksioni për të mitur. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohet, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Juve ju është shpërndarë një propozim që bën fjalë për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, relacioni që keni përpara? Dua të sqaroj se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier nuk ka seksion për të mitur dhe kemi modifikuar, është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për 5 çështjet gjyqësore, të jetë 3, që do të thotë 2 gjyqtarë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe 1 gjyqtar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (seksioni për të mitur).

Atëherë, nuk ka asnjë përjashtim nga shorti. Ka edhe një përjashtim nga shorti që më bëhet e ditur vetëm së fundi, që ishte gjyqtarja {...}, e cila është përjashtuar nga shorti me vendim të KLD, atëherë me vendimin nr. 54, datë 19.11.2018 për një periudhë 6-mujore. Kështu që ngelën për t'u shortuar 2 gjyqtarë që janë {...} dhe {...}, të cilët do caktohen për gjykimin e 2 çështjeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që i bie që nuk do bëjmë më short për shkak të përjashtimit tashmë të gjyqtarës {...}. Janë

çështjet me nr. 1 dhe 2. Çështja nr. 3 janë caktimi i 2 gjyqtarëve që automatikisht janë gjyqtarët {...} dhe {...}.

Do bëjmë short për çështjen nr. 1 dhe 2 mes këtyre dy gjyqtarëve (kush do caktohet në çështjen nr. 1 dhe kush do caktohet në çështjen nr. 2).

Atëherë, për çështjen nr. 1 shorti përzgjedh gjyqtarin {...}.

Ndërsa për çështjen nr. 2 mbetet gjyqtari {...}.

Për çështjen nr. 4 duhet të përzgjedhim gjyqtarin nga seksioni për të mitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Janë 3 gjyqtarë në seksionin për të mitur. Përzgjedhim njërin – është {...}. Gjyqtari i përzgjedhur për të gjykuar çështjen nr. 4 sipas listës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Me kaq mbyllet edhe rrethi gjyqësor Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë**.

Atëherë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë kërkohet caktimi i gjyqtarëve në 5 çështje (2 penale dhe 3 civile). Në 4 çështje kërkohet 1 gjyqtar dhe në 1 çështje kërkohen 3 gjyqtarë.

Propozimi që ju keni përpara është me dy variante. Kemi propozuar që gjykata të jetë ose Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet ose Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Në një kohë që numri i gjyqtarëve që kemi propozuar është, që duhet të caktohet, është 3.

Ne morëm informacion pak përpara mbledhjes që gjyqtarja {...}, si më lart ju parashtrova, është përjashtuar nga shorti për një periudhë 6-mujore nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Në këto kushte kemi modifikuar propozimin, kemi konsideruar që 3 gjyqtarët të zgjidhen mes Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjirokastrë. Pra treshja të formohet nga të gjithë gjyqtarët (kush do dali 3), për shkak se Gjykata e Përmetit ngalet me 2 dhe Gjykata e Gjirokastrës për një numër çështjesh ka gjyqtarë që përjashtohen, për çështje të veçanta. Kështu që po i fusim në një enë emrat e të gjithë gjyqtarëve që nuk përjashtohen të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Jeni dakord me këtë propozimin e dytë?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Fusim emrat e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Shorti përzgjedh emrat e 3 gjyqtarëve: {...}, {...} dhe {...}, të cilët do të ngarkohen për gjykimin e 5 çështjeve në Gjykatën e Rrethit Sarandë.

Do bëjmë shortin për çështjen e 1-rë. Atëherë, për çështjen e 1-rë që kërkohen 3 gjyqtarë, nuk ka asnjë pengesë ligjore nga të tre gjyqtarët që u përzgjedhën me short më herët nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjirokastrë.

Ndërkohë që janë edhe 4 çështje të tjera gjyqësore për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Do të fillojmë shortin për çështjen nr.2, 3 dhe 4, për të përzgjedhur 1 gjyqtar që duhet të marrë pjesë në përbërje të trupit gjykues.

Atëherë, për çështjen nr. 2, gjyqtari që përzgjidhet është – {...}.

Për çështjen nr. 4 është gjyqtari – {...}.

Për çështjen nr. 3 është gjyqtari – {...}.

Ndërkohë që është edhe çështja nr. 5 që duhet të hedhim shortin. Tek çështja nr. 5 kanë pengesë ligjore shumë gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, mes tyre është {...} dhe për këtë shkak shorti do të hidhet mes dy gjyqtarëve {...} dhe {...}. Pra çështja nr. 5 do të përzgjidhet mes këtyre dy gjyqtarëve – {...}. Për çështjen nr. 5 për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, përzgjidhet gjyqtari {...}, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Me kaq mbaron edhe Saranda.

(Ribëhet edhe një herë shorti për çështjen e 5-të.)

Do hedhim shortin për çështjen nr. 5 mes të 3 gjyqtarëve, se nuk kishte pengesë ligjore {...}. Duhet të përsëritet shorti për çështjen nr. 5. Prapë u rizgjedh {...} për çështjen nr. 5. Mbyllet Saranda.

Vazhdojmë **me Përmetin**. Përmeti ka 2 çështje (1 kërkohet 1 gjyqtar dhe 1 kërkohen 2 gjyqtarë). Kemi propozuar që për 2 çështjet gjykata nga duhet të caktohen të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, duhet të përzgjedhim 2 gjyqtarë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Kemi thënë që këtu të përjashtohet kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, {...}.

Është {...} Kore dhe {...}. Të 2 gjyqtarët do të ngarkohen për shqyrtimin e çështjes nr. 2 për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë. Ndërkohë, mes këtyre të dyve, do të zgjedhim njërin për të gjykuar në çështjen nr. 1 - është gjyqtari {...}. Me kaq mbyllet edhe Përmeti.

Vazhdojmë me Durrësin. Atëherë, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës** ka nevojë për 2 çështje (1 civile, 1 penale) ku kërkohet 1 gjyqtar. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, që është nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve, për të dy çështjet, të jetë 1.

Atëherë, duhet të përzgjedhim 1 gjyqtar. Jeni dakord të jetë Gjykata e Elbasanit dhe 1 gjyqtar për të gjykuar në 2 çështjet?

Atëherë, do të zgjedhim 1 gjyqtar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan nga e gjithë trupa civile dhe penale. Përfshihet kryetari {...}.

Atëherë – {...}.

Gjyqtari që kërkohet në të dy çështjet që kërkohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës 1 dhe 2 është gjyqtari {...}. Mbaruar edhe me Durrësin.

Vazhdojmë **me Kavajën**. Çështjet që kërkohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë janë 3. Në 3 rastet kërkohet 1 gjyqtar. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen gjyqtarët për gjykimin e këtyre 3 çështjeve, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet të jetë 1 (të zgjidhet nga Seksioni Penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, meqenëse janë çështje penale të tria). Përfshihet kryetarja nëse është në seksionin penal dhe {...} se ka pengesë.

(Përzgjidhet {...}.)

{...}. Pra për të tre çështjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë 1, 2, 3, gjyqtari i përzgjedhur nga shorti është {...}. Me kaq mbyllet edhe Kavaja.

Vazhdojmë me gjykatat e juridiksionit administrativ.

Jemi me **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë**. Kërkohet caktim gjyqtari në 7 çështje gjyqësore (në 4 çështje duhet 1 gjyqtar, në 2 çështje duhen 3 gjyqtarë dhe në 1 çështje duhen 2 gjyqtarë). Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen gjyqtarët për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata Administrative e

Shkallës së Parë Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen të jetë 4. Duhet të zgjedhim 4 gjyqtarë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë – {....}, {....}, {....} dhe {....}.

Atëherë, janë 2 çështje 1-shi dhe 7-a për të cilat kërkohen 3 gjyqtarë.

Për çështjen nr. 1 do të përzgjedhim 3 gjyqtarë – ata janë {....}, {....} dhe {....}. {....} është edhe relator për çështjen.

Është edhe çështja nr. 7 e cila do hidhet për short mes 4 gjyqtarëve.

Atëherë, çështja nr. 7 është – {....}, {....} dhe {....}. {....} i bie të jetë relatori tek çështja nr. 7.

Janë 4 çështje të tjera, 2-shi, 3-shi, 4-a dhe 6-a për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Do fusim në një enë 2-shin, 3-shin, 4-ën dhe 6-ën dhe nga ana tjetër emrat e 4 gjyqtarëve për të përzgjedhur.

Për çështjen nr. 4 përzgjidhet gjyqtari – {....}.

Për çështjen nr. 2 përzgjidhet gjyqtar – {....}.

Për çështjen nr. 6 përzgjidhet gjyqtar – {....}.

Për çështjen nr. 3 përzgjidhet gjyqtar – {....}.

Është edhe çështja nr. 5 për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë. Do i përzgjedhim po mes tyre, duke përjashtuar dy gjyqtarët që janë caktuar relatorë, do përzgjedhim mes këtyre 2 të tjerëve. Atëherë, për çështjen nr. 5 hedhim shortin mes 2 gjyqtarëve – {....} dhe {....} tek çështja nr. 5 për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë. Me kaq mbyllet shkalla e parë administrative Gjirokastër.

Tani kemi Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Kërkohet gjyqtar në 4 çështje (3 çështje 1 gjyqtar dhe në 1 çështje 3 gjyqtarë). Kemi propozuar përsëri Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe numri i gjyqtarëve 3. Dakord?

Brunilda Kadi: Unë jam kundër për të.

Mendoj që, meqenëse u caktua për Gjirokastër, mendoj që duhet të zgjidhet një gjykatë tjetër.

Ilir Toska: Kemi propozuar që të përjashtojmë nga shorti gjyqtarët që caktuam në Gjirokastër. Ata nuk marrin pjesë më në short.

Brunilda Kadi: E kuptoj, e kuptoj. Por gjyqtarët e shkallës së parë administrative Tiranë, pavarësisht se mund të kenë në dorë çështje më pak se gjyqtarët e tjerë, ata heqin shumë dhe nuk e di se çfarë kriteri është pasur parasysh në total... Unë jam kundër njëherë. Propozoj që të caktohet një gjyqtarë tjetër e shkallës së parë administrative.

Ilir Toska: Atëherë, ta votojë Këshilli nëse ka propozim kundër...

Alban Toro: Gjirokastra e ka 96-111 ({....}, {....}). Korça ka {....} 160, {....} 230. Në dorë. Durrësi 81 {....}, {....} 430, {....} 475, {....} 221. ...

Naureda Llagami: Me shumicë votash dakord. Pranohet.

(Përzgjidhen 3 gjyqtarë.)

{....}, {....} dhe {....}.

Për çështjen nr. 1 për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, janë gjyqtarët e përzgjedhur më lart, ku gjyqtarja {....} është gjyqtarja relatore.

Për 3 çështjet e tjera për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, 2-shi, 3-shi, 4-a, caktojmë mes këtyre 3 gjyqtarëve.

(Nga anëtarët kujtojnë që gjykata për të cilën po bëhet shorti është Korça.)

Ah, jemi në Korçë. Jemi për Gjykatën e Shkallës së Parë Korçë.

Atëherë, jemi duke hedhur shortin për **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë** e cila ka nevojë për 4 çështje që propozuam nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë 3 gjyqtarë: që u përzgjedhën {....}, {....} dhe {....}. Gjyqtarja {....} është automatikisht edhe relatorja për çështjen nr. 1.

Do të vazhdojmë shortin 2, 3, 4 për të cilat kërkohet 1 gjyqtar. Do të fusim në një enë 3 numrat e çështjeve dhe në enën tjetër emrat e gjyqtarëve.

Për çështjen nr. 3 përzgjidhet gjyqtari – {....}.

Për çështjen nr. 2 përzgjidhet gjyqtari – {....}.

Dhe për çështjen nr. 4 përzgjidhet gjyqtari – {....}. Me kaq mbaron edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë.

Tani është **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër** që ka nevojë në 2 çështje për 1 gjyqtar. Edhe në këtë rast kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohet të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet, të jetë 1, duke përjashtuar gjyqtarët që u caktuan në Gjykatën e Shkallës së

Parë Administrative Gjirokastër dhe Korçë, përfshirë edhe kryetarin e gjykatës. Duhet të përzgjedhim 1 gjyqtar – {...}, i cili caktohet për të dy çështjet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar. Me kaq mbyllet edhe Shkodra, administrativja.

Jemi tek **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë**. Këtu është 1 çështje për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë. Kemi propozuar përsëri të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2, duke përjashtuar të gjithë gjyqtarët që janë caktuar më herët në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, Korçë dhe Shkodër. Jeni dakord?

Brunilda Kadi: Kundër.

Për Shkodrën apo për Vlorën?

Ilir Toska: Tani është Vlora.

Brunilda Kadi: Okej! Unë mendoj që duhet të shkojë nga një gjykatë që është afër sepse është edhe shpenzim. Propozoj që të jetë Gjykoakra, të delegohet për në Vlorë. Jo Tirana.

Brikena Ukperaj: Edhe unë, referuar ngarkesës, duke marrë parasysh që gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë i kemi deleguar/i kemi caktuar në Gjirokastër, në Korçë, në Shkodër, duke marrë parasysh ngarkesën e gjyqtarëve të Gjykatës Gjirokastër krahasimisht me ata të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë, propozoj që Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë të plotësohet me gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër (*Administrative*)

Naureda Llagami: Dakord me propozimin e Komisionit?

(*Anëtarët janë dakord, përveç dy kundra.*)

Vazhdojmë procedurën e shortit për zgjedhjen e 2 gjyqtarëve nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për të gjykuar 1 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Përzgjedhim emrat e 2 gjyqtarë – janë {...} dhe {...}. Me kaq mbyllet edhe Administrativja e Shkallës së Parë Vlorë.

Dhe e fundit është **Administrativja e Shkallës së Parë Tiranë**. Kërkohet në 1 çështje caktimi i 1 gjyqtari.

Kemi propozuar që të zgjidhet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Duke përjashtuar kryetarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, {...}, duhet të hedhim short mes gjyqtarëve të tjerë për të përzgjedhur njërin prej tyre. Përzgjidhet {...}. Pra për çështjen e vetme të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë përzgjidhet gjyqtari {...}. Kjo ishte edhe e fundit. Faleminderit shumë!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë me kaq mbaroi mbledhja. Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Për mbledhjen e ardhshme do diskutojmë të hënën për ditën kur do e lejmë dhe aktet që do propozojmë për mbledhjen e radhës. Faleminderit! Ditë të mbarë!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor